

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 29, 17 - 23 Korrik 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 29

	JAVA 29
DIARRE PA GJAK	2.557
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	5.555
INF. RESP. TE POSHTËME	2.163
RASH ME TEMPERATURË	4
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	395
% e Njësive Raportuese	93% (395/427)

Rash me temperaturë

2 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit dhe 2 raste nga rrethi i Pogradecit. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rretheve rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë.


Helmim Ushqimor në Tropojë

Në datën 17.07.2017, (ora 18.⁰⁰) Instituti i Shëndetit Publik njoftohet nga shefi i higjienës dhe epidemiologjisë në D.SH.P Tropojë, Dr. Urim Breçani, për një rritje të pazakontë të rasteve me gastroenterite në Urgjencën e Spitalit të Bajram Currit. Dr. Urimi ka marrë njoftim nga Spitali i Bajram Currit rreth orës 2.³⁰ të datës 17.07.2017. Nga hetimi epidemiologjik i ISHP dhe DSHP Tropoje rezulton që në total janë përfshirë 104 persona të rritur dhe fëmijë me helmim ushqimor. Ata kanë konsumuar qofte në një qebaptore në qytetin e Bajram Currit nga data 16.07.2017 deri në datën 17.07.2017 dhe nga analiza e menysë për çdo rast vërejmë se konsumi i qofteve përbën produktin kryesor të përbashkët të konsumuar. Në urgjencën e pediatriisë janë paraqitur 14 fëmijë të moshës 2-14 vjeç me helmim ushqimor, të cilët kanë konsumuar qofte bashkë me prindërit e tyre. Të rritur janë 90 persona, pjesa më e madhe e tyre janë rikthyer serish në urgjencë për të marrë perfuzione. Nga hetimi epidemiologjik vërehet se mbizotëron moshë e re 15-30 vjeç sepse kjo moshë frekuenton më shumë qebaptoren e qytetit.


Pacientët kanë patur keto shenja klinike: diarre të ujshme pa gjak dhe pa mukus, temperaturë të lartë deri në 39°C, të shoqëruar ose jo me të vjella, nauze dhe dhimbje epigastrike. DSHP Tropojë komunikoi menjëherë me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor të Tiranës dhe të Kukësit me një shkresë të posaçme ku u sugjerua edhe mbyllja provizore e aktivitetit për të ndërprerë zinxhirin e infeksionit. Lokali është mbyllur në datën 17. 07. 2017 pasdite. Nga hetimi epidemiologjik dhe duke u mbështetur në pergjigjet e analizave të koprokulturave që u morrën dhe u analizuan në ISHP, rezulton se personat janë të infektuar me *Salmonella enteritidis* gr-D.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet 12% ritje në javën 29 krahasuar me javën paraardhëse, java 28.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 29 krahasuar me javën paraardhëse, java 28.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 29 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.




Në javën e 29 të vitit 2017 vërehet një trend në rënie i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 5% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën e 29 të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 28 dhe 29 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)




Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 01 – 29 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.



Në javën e 29 të vitit 2017 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarreve pa gjak” dhe ky numër është 36% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 28 dhe javën 29 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Ne rrethin e Tropojës numri i rritur i rasteve është si pasojë e shpërthimit të helmimit ushqimor të ndodhur në këtë rreth, ndërsa në rrethet e tjera, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 29 sipas rretheve, në përqindje.

